Kronikë

# Lezhë, autor i 3 vjedhjeve, në pranga 32-vjeçari, në banesë iu gjet kallashnikov dhe fishekë

*Një 32-vjeçar ka rënë në pranga pasi ishte shpallur në kërkim si autor i 3 vjedhjeve në Lezh*

*Armët e sekuestruara*

Redaksia
17 Shkurt, 10:43 | **Përditesimi: 17 Shkurt, 10:45**

Një 32-vjeçar ka rënë në pranga pasi ishte shpallur në kërkim si autor i 3 vjedhjeve në Lezhë. Bëhet fjalë për Eduard Lleshin.

> *"Lezhë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Blinishti" sekuestrohen 1 armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak.*

*LEXO EDHE:*
***'Besëlidhja' e Lezhës mbetet pa shtëpi, stadiumi do shembet! Bashkia: S'do bëjmë pallate, por parking e lulishte***

*Autor i dyshuar i disa vjedhjeve, kapet dhe vihet në pranga 32-vjeçari që mbante në banesë, 1 armë zjarri kallashnikov, krehra armësh dhe qindra fishekë luftarak.*

*Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë, si rezultat i punës operacionale në terren, për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërive, për zbardhjen e atyre të ndodhura më parë dhe për vënien në pranga të shtetasve të shpallur në kërkim, të mbështetura nga inteligjenca informative, kanë organizuar dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Blinishti"*

*Si rezultat i këtij operacioni, u kap dhe u arrestua në flagrancë shtetasi E. Ll., 32 vjeç, banues në Blinisht, Lezhë.*

*Gjatë kontrollit në banesën e 32-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 1 armë zjarri kallashnikov, 2 krehra arme dhe 155 fishekë luftarak.*

*Nga veprimet hetimore të kryera për këtë rast, dyshohet që shtetasi E. Ll. është gjithashtu, autor i vjedhjeve të materialeve, në 3 banesa në fshatra të ndryshme të Lezhës, vjedhje të kryera në datat 02.12.2022, 17.12.2022 dhe 14.02.2023.*

*Vijojnë veprimet hetimore për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të rasteve të tjera të vjedhjeve që mund të jenë kryer nga ky shtetas.*

*Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme."-thuhet në njoftimin e policisë.*

Në përditësim...

G.MO/Shqiptarja.com

**TAG:** Lezhe | vjedhje | Eduard Lleshi

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

**Sondazhi i ditës:**
**Kosova 15 vite pavarësi, a është aty ku duhet bashkëpunimi me Shqipërinë?**

PO | JO | NUK KAM MENDIM

## Lajme të tjera

**Skandali në gjimnazin e Laçit/ Plagosja me armë zjarri e 15-vjeçarit, lirohet nga qelia 17-vjeçari! Gjykata e lë në arrest shtëpie**
16 Shkurt, 14:22

**Skandal në gjimnazin e Laçit, dy ditë më parë u plagos me armë një i mitur, institucionet heshtin! Aktivistët për Report Tv: S'është hera e parë, të miturit konsumojnë edhe drogë në shkollë**
15 Shkurt, 12:09

**Miratohet projekti, ndërhyrje emergjente në Urën e Zogut! Reagimet e vazhdueshme marrin vëmendjen e qeverise për shpëtimin e këtij monumenti**
14 Shkurt, 12:36

**Plagosi me armë zjarri në mes të gjimnazit 15-vjeçarin në Laç, arrestohet adoleshenti! U kap në një banesë të braktisur në Kurbin**
Elvis Hila
14 Shkurt, 09:29

**Përleshen dy adoleshentët pranë gjimnazit në Laç, 17-vjeçari qëllon me armë zjarri në këmbë 15-vjeçarin**
13 Shkurt, 12:56

**Aksident i rëndë në Lezhë, makina përplas për vdekje 42-vjeçarin! Drejtuesi i mjetit shoqërohet në polici (VIDEO)**
12 Shkurt, 20:23

**Prej 55 vitesh rrobaqepës! 70-vjeçari që qep kostume për burra në Lezhë: Ishim familje e persekutuar, nisa punën kur mbarova klasën e 8-të**
Elvis Hila
12 Shkurt, 19:29

**Kurbin, banorët e Shënmërisë ndërtojnë rrugën e fshatit: Po investojmë të gjithë me ndihma! Na kanë braktisur fare**
Elvis Hila
12 Shkurt, 16:21




**Video ekskluzive/ Zbardhen 53 grabitje të kryera nga tre adoleshentë në Shkodër! Ja sesi arrinin të vidhnin në banesa dhe dyqane**
12 Shkurt, 10:22

**Dëmtohet çatia e memorialit të 'Skënderbeut' në Lezhë! U restaurua vetëm 5 vite më parë nga Ministria e Kulturës**
Elvis Hila
10 Shkurt, 15:38

**Erdogan rindërtoi lagjen në Laç, banorët të gatshëm mirëpresin qytetarët turq: Kemi hapur shtëpinë dhe zemrën prej tërmetit tragjik**
Elvis Hila
9 Shkurt, 11:45

**Rama ndan videon nga projekti për rikonstruktimin e spitalit të Lezhës, shërbime më të mira për qytetarët**
9 Shkurt, 08:29

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje